

# GJYKATA E QARKUT MITROVICE

P Nr. 349/07

18 shkurt 2010

## NE EMER TE POPULLIT

**GJYKATA E QARKUT NE MITROVICE**, me Trupin Gjykses te përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, Kryetare e Trupit Gjykses dhe Gjyqtarët e EULEX-it Klaus Jung dhe Nikolay Entchev, anëtarë të Trupit Gjykses, me pjesëmarrjen e Tara Khan Keshilltare Ligjore e EULEX-it, si procesmbajtese, ne lëndën penale kunder:

**Esat TAHIRIT**, akuzuar per vepren penale të Vrasjes, sipas Nenit 146 te Kodit te Përkohshëm Penal të Kosoves (KPPK) dhe **MBAJTJA NË PRONËSI, KONTROLL, POSEDIM OSE NË SHFRYTËZIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE**, sipas Nenit 328 Paragrafi (2) KPPK, dhe

**Artan DOROCIT**, akuzuar per Shtytje në Vrasje, sipas ne kundershtim me Nenin 146 te KPPK-së në bashkim me Nenin 24 KPPK dhe **MBAJTJE NË PRONËSI, KONTROLL, POSEDIM OSE SHFRYTËZIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE**, sipas Nenit 328 Paragrafi (2) KPPK, sipas Aktakuzës së Prokurorit Publik te datës 27 Korrik 2006 të ndryshuar në shqyrtimin e parë kryesor më datë 07 Dhjetor 2006;

Pas mbajtjes së seances publike mbi pranimin e marrëveshjes së fajësise më datë 27 janar 2010, më datë 03 shkurt 2010, në praninë e të akuzuarve Esat Tahiri dhe Artan Doroci, avokatëve mbrojtës Kosovare Kelmendi dhe Bajram Tmava, Prokurores Publike të EULEX-it Mariah Bamieh dhe Perfaqësuesit së Palës së Dëmtuar Bashkim Hasani (në pjesën e pare te seances) pasi pati pranuar marrveshjen e fajësise në të njëjtën ditë dhe pasi ishte dorezuar në Gjykate në orën 9:00 më datë 18 shkurt 2010 dhe pas mbajtjes se seancës publike mbi dënimin më 18 Shkurt 2010, në praninë e dy te akuzuarve, avokatëve të tyre mbrojtës dhe Prokurores Publike te EULEX-it, pas diskutimit dhe votimit te Trupit Gjykses mbajtur në 18 shkurt 2010, sipas **Nenit 308A pika 15 e Kodit të Procedurës Penale te Kosoves (KPPK)** shpalli publikisht dhe në praninë e dy të Akuzuarve, avokatit te tyre mbrojtës dhe Prokurores Publike te EULEX-it si më poshtë këtë;

## AKTGJYKIM

I akuzuari **Esat TAHIRI**, djali i Bilall Tahirit dhe Xhezide Salihut, i lindur më 26 gusht 1981, në Mitrovicë, Kosovar Shqiptar, me vendbanim në Mitrovicë, rruga Metush Krasniqi, i martuar, baba i një femije tre vjecar, me shkollim shkollën fillore, tregtar me profesion, gjendja ekonomike i varfer, nuk dihet që të jetë dënuar më parë, në paraburgim që në 20 maj 2006.

Ka pranuar fajësinë për veprën penale Vrasje në kundërshtim me Nenin 146 te Kodit te Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe **MBAJTJA NË PRONËSI, KONTROLL, POSEDIM OSE NË SHFRYTËZIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE** në kundërshtim me Nenin 328 Paragrafi (2) i KPPK-së sipas Marrëveshjes për Fajësi të datës 27 janar 2010 dhe pasi gjykata e ka pranuar Marrëveshjen e Fajësisë të datës 27 janar 2010 dhe ndryshoi në seancën e 03 shkurtit 2010, sic është paraqitur në gjykatë më 18 shkurt 2010

është

### DENUAR

- me 7 /shtate/ vite burgim për veprën penale të Vrasjes
- me 2 /dy/ vite burgim për veprën penale **MBAJTJA NË PRONËSI, KONTROLL, POSEDIM OSE NË SHFRYTËZIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE**.

Dënimi unik përcaktohet me **8 /tetë/ vite burgim**, sipas Nenit 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) Pika 2 e KPK-së.

Koha e kaluar në paraburgim që ne 20 maj 2006 duhet të zbritet sipas Nenit 73 Paragrafi (1) i KPK-se.

I akuzuari **Artan DOROÇI**, djali i Faik Dorocit dhe Vahide Gashit, i lindur ne 14 maj 1979, në Mitrovicë, Shqiptar Kosovar, me vendbanim në Mitrovicë, Durrresi 377, i martuar, babai i dy femijeve (gjashtë dhe tre vjecarë), me shkollim maksimal shkollën tetëvjeçare, bashkëpronar i firmes Nori, gjendja ekonomike e mesme, nuk dihet te jete dënuar më parë, në paraburgim që nga 20 maj 2006 deri ne 09 tetor 2006, nga 20 dhjetor 2006 deri ne 25 shtator 2008, e më pas ne arrest shtëpiak deri ne 20 janar 2009,

- Pasi ka pranuar fajësinë për veprën penale **DHËNIA E NDIHMËS KRYERËSVE PAS KRYERJES SË VEPRAVE PENALE** sipas Nenit 305 Paragrafi (2) i KPK-se dhe **MBAJTJA NË PRONËSI, NË KONTROLL, NË POSEDIM OSE NË**

**SHFRYTËZIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE** sipas Nenit 328 Paragrafi (2) i KPK-se sipas Marrëveshjes së Fajësisë të datës 27 janar 2010 dhe

Gjykata pasi ka pranuar Marrëveshjen e Fajësisë të datës 27 janar 2010 dhe të ndryshuar në seancën e datës 03 Shkurt 2010, siç është paraqitur në Gjykatë në 18 shkurt 2010

Eshtë

**DENUAR**

- me 2 /dy/ vite burgim për veprën penale **DHËNIA E NDIHMËS KRYERËSVE PAS KRYERJES SË VEPRAVE PENALE**
- me 1 /nje/ vit dhe 6 /gjashte/muaj burgim per veprën penale të **MBAJTJA NË PRONËSI, KONTROLL, POSEDIM OSE NË SHFRYTËZIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE**

Dënimi unik përcaktohet me 3/ tre vjet burgim, sipas Nenit 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) Pika 2 e KPK-së.

Koha e kaluar në paraburgim dhe ne arrest shtepiak mes 20 Maj 2006 dhe 20 Janar 2009 duhet t'i zbritet sipas nenit 73 Paragrafi (1) i KPK-se.

Te akuzuarit Esat Tahiri dhe Artan Doroci duhet të kompensojne- në shuma te barabarte - shpenzimet e procedurës penale sipas Nenit 102 Paragrafi (1) i KPK-së me përjashtim te shpenzimeve te perkthimit. Gjykata do te nxjerre nje Vendim te veçantë për shpenzimet kur këto te dhëna te merren sipas Nenit 100 Paragrafi (2) i KPK-së.

**ARSYETIMI**

**A. PRAPAVIJA PROCEDURALE**

Zyra e Prokurorisë Publike të Qarkut Mitrovicë, me aktakuzën PP. nr. 148/06 më datë 27 korrik 2006 ka akuzuar Esat Tahirin për Vrasje në kundërshtim me Nenin 146 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe Mbajtje në Pronësi, Kontroll, posedim ose Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim me Nenin 328 Paragrafi (2), KPPK. Artan Doroci akuzohej për Pjesëmarrje në Rrahje sipas Nenit 155 Paragrafi (1) KPPK dhe Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim ose Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve sipas Nenit 328 Paragrafin (2) KPPK. Gjatë fjalës përfundimtare të shqyrtimit të parë kryesor më datë 07 dhjetor 2006 Prokurori Publik ndryshoi aktakuzën si dhe

kualifikimin ligjor të akuzës së parë kundër Artan Doroci në Shtytje në kryerjen e veprës penale të Vrasjes, sipas Nenit 146 KPPK në bashkim me Nenin 24, KPPK.

Shqyrtimi i parë kryesor në Gjykatën e Qarkut Mitrovicë përfundoi më 20 dhjetor 2006 dhe aktgjykimi P. 262/06 u shpall të njëjtën ditë. Trupi Gjykues shpalli të dy të akuzuarit fajtorë sipas aktakuzës dhe dënoi Esat Tahirn me dënimin unik prej 13 vitesh me zbritje kohën e kaluar në paraburgim dhe Artan Dorocin me dënimin unik prej 7 vitesh me zbritje të kohës së kaluar në paraburgim.

Gjykata Supreme e Kosovës, me Vendimin Ap. nr. 216/07, të datës 21 nëntor 2007 anuloi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ktheu lëndën për ri-gjykim.

## **B. KOMPETENCA E GJYKATËS**

Sipas Nenit 23 Pika 1) i) KPPK, gjykatat e qarkut janë kompetente për të shqyrtuar lëndët penale për të cilat ligji parashikon dënimin penal me të paktën pesë vjet. Në pajtim me Nenin 27 paragrafi (1) KPPK, kompetenca territoriale është në përputhje me gjykatën e qarkut ku supozohet se është kryer vepra penale.

Siç u tha më lart, akuza e Vrasjes, në pajtim me Nenin 149 KKP, lejon dënimin minimal me pesë vjet burgim. Për më tepër, aktakuza në këtë lëndë supozon se të akuzuarit kanë kryer veprën penale në Mitrovicën e Jugut.

Për këtë arsye, Gjykata e Qarkut Mitrovicë është organi ligjor kompetent për të shqyrtuar këtë procedurë penale.

Më datë 14 tetor 2009 Kryetari i Asamblesë së Gjykatëve të EULEX-it transferoi lëndën Gjykatësve të EULEX-it sipas Nenit 3.3 dhe 3.5 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it.

Për këtë arsye, gjykatësit e EULEX-it të caktuar pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë janë kompetentë për të gjykuar këtë lëndë penale. Trupi Gjykues përbëhej nga Gjykatësja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, Kryetare e Trupit Gjykues dhe Gjykatësit e EULEX-it Klaus Jung dhe Nikolay Entchev, anëtarë të Trupit Gjykues. Të tre gjykatësit janë caktuar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

Asnjë nga palët nuk ka pasur kundërshtim mbi përbërjen e Trupit Gjykues.

Ri-gjykimi para Trupit Gjykues të përbërë nga gjykatësit e EULEX-it ishte caktuar të fillonte më datë 25 janar 2010, por u shty për shkak të diskutimeve mbi fajësinë mes palëve.

## C. MARRËVESHJA MBI FAJËSINË

Marrëveshja mbi fajësinë iu paraqit Trupit Gjykues gjatë një seance të shqyrtimit kryesor, sipas Nenit 308/A pika 9 KPPK, më datë 03 shkurt 2010.

I akuzuari Esat Tahiri u deklarua fajtor për Vrasje, Neni 146 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe Mbajtja në Pronësi, Kontroll, Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve, Neni 328 Paragrafi (2) KPPK. I akuzuari Artan Doroci u deklarua fajtor për Dhënien e Ndhmës Kryerëve pas Kryerjes së Veprave Penale, Neni 305 Paragrafi (2) KPPK dhe Mbajtja në Pronësi, Kontroll, Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve, Neni 328 Paragrafi (2) KPPK.

Marrëveshja mbi Fajësinë përmbante gjetjet faktike si në vijim:

Më datë 19 maj 2006 në restorantin Adriatik në Mitrovicë, viktimi Kujtim Hasani kishte pirë disa pije me disa shokë dhe rreth orës 23:00, ndërkohë që po largohej nga restoranti, kishte thyer një shishe birre. I akuzuari Tahiri kishte parë këtë dhe ishte konfrontuar verbalisht Hasanin. Pas këtij diskutimi verbal Hasani shkoi me shokët e tij në bastoren “Doni” që ndodhet në rrugën Shemsi Ahmeti. Pas pesëmbëdhjetë-njëzet minutash të akuzuarit Tahiri dhe Doroci shkuan në bastore – bastorja është pesë minuta larg nga restoranti Adriatik – me një Audi ngjyrë të zezë, pronar i të cilit ishte Artan Doroci. Esat Tahiri ishte i armatosur me një revolver; Artan Doroci kishte lënë Kallashnikovin e tij në makinë. Esat Tahiri shkoi tek Kujtim Hasani dhe e goditi me qytën e revolverit dhe pastaj e qëlloi. Plumbi depërtoi në pjesën e sipërme të majtë të kokës, kaloi përgjatë trurit dhe doli në pjesën e djathtë të maksillës, gjë e cila rezultoi në vdekjen e tij më datë 23 maj 2006 në orën 11:50.

Esat Tahiri dhe Artan Doroci u larguan nga vendi me makinën Audi. Ata u fshehën në një kishë ku dhe kaluan natën. Ditën në vijim Artan Doroci u dorëzua dhe dorëzoi edhe armën që kishte pasur në makinë. Esat Tahiri u dorëzua më vonë; edhe arma me të cilën ishte kryer vrasja u gjet.

Pala e Dëmtuar Murat Hasani, babai i viktimës ishte jashtë territorit të Kosovës ditën e seancës së shqyrtimit kryesor. Megjithatë familja autorizoi Bashkim Hasanin, xhaxhain e viktimës që t'i përfaqësonte ata. Bashkim Hasani, deklaroi gjatë seancës së 03 shkurtit 2010 se familja nuk dontë të ngrinte kërkesë për dëmshpërblim. Ai u informua nga Prokurori mbi Marrëveshjen për Fajësi pas të cilës u largua. Në pajtim me Nenin 308/A Pika 5 KPPK palës së dëmtuar duhet ti jepet mundësia që të deklarohet para trupit gjykues mbi kërkesën për dëmshpërblim. Në këtë rast, Përfaqësuesi i Palës së Dëmtuar – pasi iu dha udhëzimi dhe pasi i ishte shpjeguar kuptimi i kërkesës së dëmshpërblimit -, deklaroi shumë qartë para Trupit Gjykues se ata nuk donin të bënin kërkesë një kërkesë të tillë.

Marrëveshja mbi Fajësinë u pranua nga Gjykata ditën e shqyrtimit në pajtim me Nenin 308/A Pika 10 dhe Pika 15 KPPK, meqënëse pasi u pyetën të Akuzuarit, Avokatët e tyre Mbrojtës dhe Prokurorit Publik, Trupi Gjykues vendosi se marrëveshja e fajësisë ishte në përputhje me kushtet e parapara nga Neni 308/A Pika 12; të dy të Akuzuarit kuptuan

natyrën dhe pasojat e të deklaruarit të fajësisë, ata kanë pranuar fajësinë vullnetarisht pasi janë konsultuar me avokatët e tyre mbrojtës, ata nuk janë detyruar në asnjë loj mënyre për t' u deklaruar fajtorë. Për më tepër deklarimi i fajësisë mbështetet nga faktet dhe provat e lëndës, dëshmitë e dëshmitarëve, deklaratat e të Akuzuarve dhe provat dokumentuese të dosjes së lëndës. Për këtë arsye, në pajtim me Nenin 308/A Pika 15 KPPK Gjykata urdhëroi që Marrëveshja për Fajësi të dorëzohet pranë Gjykatës dhe caktoi seancën për dënim më datë 18 shkurt 2010.

Marrëveshja për Fajësi u dorëzua Trupi Gjykues më datë 18 shkurt 2010 në orën 9:00.

## **D. DËNIMI**

Më datë 18 shkurt 2010 trupi gjykues dëgjoi argumentat mbi dënimin nga të gjitha palët. Palët paraqitën të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe pas diskutimit Trupi Gjykues caktoi dënimin në pajtim me Nenin 308/A Pika (15) KPPK.

Kur cakton dënimin penal Trupi Gjykues duhet të ketë parasysh dy qëllime, qëllimin e përgjithshëm – që të shtypë aktivitetet e rrezikshme shoqërore duke parandaluar që të tjerët të kryejnë vepra të ngjashme penale, dhe qëllimin specifik – që të parandalojë që kryerësi të kryejë përsëri veprën penale. Kur përcakton kohëzgjatjen e dënimit Trupi Gjykues duhet të vlerësojë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, në pajtim me Nenin 64 paragrafi (1) KPK.

Në rastin e Esat Tahirit Gjykata konsideroi si rrethana rënduese faktin që viktima ishte i moshës 19 vjeçare dhe fakti se të Akuzuarit kanë kryer veprën penale të armatosur. Megjithatë, rrethanat lehtësuese peshojnë më shumë se rrethanat rënduese. I akuzuari nuk ka qenë i dënuar më parë, ai e ka pranuar veprën penale që nga fillimi i procedurës penale, ai ka shfaqur pendim të sinqertë dhe ka marrë përgjegjësi për atë që ka kryer. Për më tej rrethanat lehtësuese janë; pajtimi me palën e dëmtuar, babain e viktimës; i Akuzuari ka qenë në paraburgim për një kohë jashtëzakonisht të gjatë; dhe ai ka një fëmijë tre vjeçar.

Në rastin e Artan Doroci Gjykata ka konsideruar si rrethanë rënduese faktin se viktima ishte i moshës 19 vjeçare. Rrethanat lehtësuese edhe në këtë rast peshojnë më shumë se rrethanat rënduese. Ai nuk ka qenë më parë i dënuar, ka shfaqur pendim të sinqertë dhe është pajtuar me familjen e viktimës. Ai ka dy fëmijë të vegjël dhe presin një të tretë.

Në rastin e të akuzuarit Esat Tahiri;

Për veprën penale të Vrasjes në pajtim me Nenin 146 KPK, ligji parashikon dënimin me të paktën 5 vjet burgim. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues urdhëroi për këtë veprë penale dënimin me 7 vjet burgim.

Për veprën penale Mbajtja në Pronësi, Kontroll, Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në pajtim me Nenin 328 Paragrafi (2) KPK, ligji parashikon dënim me gjobë ose burgim nga 1 deri 8 vjet. Trupi Gjykues urdhëroi dënimin me 2 vjet burgim.

Në rastin e të akuzuarit Artan Doroci;

Për veprën penale Dhënia e Ndhmës Kryerësve pas Kryerjes së Veprave Penale në pajtim me Nenin 305 Paragrafi (2) KPK, ligji parasheh dënim me burgim nga 6 muaj deri 5 vjet. Duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues urdhëroi 2 vjet burgim për këtë vepër penale.

Për veprën penale Mbajtja në Pronësi, Kontroll, Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në pajtim me Nenin 328, Paragrafi (2) KPK ligji parasheh dënimin me gjobë ose burgim nga 1 deri 8 vjet. Trupi gjykues mori vendimin për dënim 1 vit dhe 6 muaj burgim.

Të dy të Akuzuarit kanë kryer dy vepra penale. Në pajtim me rregullat e llogaritjes për bashkim të veprave penale, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë por jo i barabartë me shumën e dënimeve të veçanta. Trupi gjykues përcaktoi dënimin unik prej 8 vjetësh burgim për Esat Tahiri dhe 3 vjet burgim për Artan Doroci në pajtim me Nenin 71 paragrafët (1) dhe (2) Pika 2) KPK.

I akuzuari Esat Tahiri ka qenë në paraburgim prej datës 20.05.2006 dhe i akuzuari Artan Doroci ka qenë në paraburgim prej 20 maj 2006 deri 09 tetor 2006, nga 20 dhjetor 2006 deri 25 shtator 2008, dhe më pas ne arrest shtëpiak deri 20 janar 2009. Këto periudha kohore duhet të llogariten në dënimin e caktuar me burgim në pajtim me Nenin 73 paragrafi (1) KPK.

## **E. LIGJI NE FUQI**

Veprat penale janë kryer më datë 19 maj 2006. Në atë kohë ishte në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK), i cili hyri në fuqi më datë 06 prill 2004. Në pajtim me Nenin 2 paragrafi (1) KPPK, ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale zbatohet ndaj kryerësit përveç rastit kur ligji i ri është më i favorshmi për të akuzuarin. I akuzuari është deklaruar fajtor për veprat penale sipas KPPK.

Megjithatë disa ndryshime, duke përfshirë edhe “Marrëveshjen për Fajësi” janë përfshirë në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, Ligji Nr. 03/L-003 i cili hyri në fuqi më datë 06 janar 2009 dhe Kodi i Përkohshëm Penal të Kosovës u ndryshua me anë të Ligjit Nr. 03/L-002 i cili hyri në fuqi më datë 06 janar 2009. Sigurisht, dispozitat ligjore në lidhje me marrëveshjen për fajësi mund të zbatohen vetëm në referencë të ligjeve të “reja”, Kodi Penal i Kosovës (KPK) dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK). Për këtë arsye Kodi Penal i Kosovës është më i favorshëm për të akuzuarit dhe Gjykata i është referuar këtij ligji në Aktgjykimin mbi dënimin.

## **F. SHPENZIMET**

Të akuzuarët janë shpallur fajtorë dhe për këtë arsye, në shuma të barabarta, do të paguajnë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me Nenin 102 paragrafi (1) KPPK, përveç shpenzimeve të bëra për përkthimet gjatë të gjithë procedurës penale. Gjykata do të nxjerre nje Vendim te veçantë për shpenzimet kur këto të dhëna te merren sipas Nenit 100 Paragrafi (2) KPPK.

**Procesmbajtëse**  
**Tara Khan**

**Kryetarja e Trupit Gjykes**  
**Hajnalka Veronika Karpati**

### **Mjet ligjor:**

Ky aktgjykim mbi dënimin u bë i plotfuqishëm ditën e shpalljes së tij meqënëse nuk parashihet nga Neni 308 Pika 8.1 KPPK.